



Të nderuar nxënës, mësimdhënës, prindër,

I kuptojmë shqetësimet Tuaja lidhur me Konceptin e ri për arsimin fillor. Obligimi ynë është të ofrojmë sqarime, të dëgjojmë sugjerimet Tuaja dhe të marrim vendime në interesin më të mirë të fëmijës të bazuara në dëshmi.

Koncepti për arsimin fillor është dokument që prek të gjithë ne. Ne do të japim të gjithë sqarimet e nevojshme dhe do të kryejmë këshillime dhe modifikime të nevojshme që ky dokument me rol kyç të kuptohet mirë, të pranohet gjithanshëm dhe të jetë i mbështetur shkencërisht.

Në vazhdim janë dhënë **shpjegimet** për disa nga **shqetësimet** e ndara deri më tani në lidhje me Konceptin.

Nëse edhe Ju keni dilema ose pyetje të caktuara në lidhje me Konceptin, Ju lutemi që në interes të çdo nxënësi dhe në interes të avancimit të cilësisë së arsimit tonë, të kontaktoni Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.



## SHQETËSIM

**Hiqet** lënda e historisë.



## SHPJEGIM

Përfshirja e lëndës shkenca shoqërore nuk do të thotë që lënda e historisë të hiqet, por përmbajtjet e saj **bëhen pjesë e detyrueshme** e programit të integruar mësimor. Përmes integrimit të përmbajtjeve nga historia, arsimit qytetar dhe gjeografia, **mësimdhënësit e këtyre lëndëve vazhdojnë të punojnë në shkollë**, por tani **së bashku planifikojnë mësimdhënien**, i ndërlidhin fenomenet dhe proceset shoqërore, kurse nxënësit i mësojnë ato nga këndvështrime të ndryshme.



## SHQETËSIM

**Fshihen përmbajtje** të lëndës së historisë.



## SHPJEGIM

Koncepti i arsimit fillor siguron "kornizën" sipas së cilës planifikohet arsimit fillor. Ky dokument **nuk fshin përmbajtje të lëndëve mësimore, as nuk parasheh ndryshimin e përmbajtjeve të lëndës së historisë.**

Zhvillimi i programeve të veçanta mësimore do të vijojë pas zhvillimit dhe miratimit të Konceptit.



## SHQETËSIM

Bashkohen **lëndë të disiplinave të kundërta** (historia dhe gjeografia).



## SHPJEGIM

Nxënia e integruar e gjeografisë, historisë dhe arsimit qytetar **ofron një ndërlidhje thelbësore** sepse ato janë dimensione themelore të së njëjtës dukuri/të të njejtit proçes. Çdo ngjarje historike është e lidhur ngushtë me mjedisin gjeografik në të cilin ka ndodhur. Nxënia e integruar e historisë dhe gjeografisë është **karakteristikë e shumicës së vendeve me sisteme të zhvilluara arsimore**. Për shembull, kjo është mënyra më e mirë për t'u shpjeguar nxënësve se ku dhe si u zhvilluan civilizimet antike dhe cilat kushte natyrore ndikuan në kulturën e tyre.



## SHQETËSIM

Integrimi i më tepër  
lëndëve do të thotë  
**mësimdhënie me cilësi  
të dobët.**



## SHPJEGIM

Programet e integruara mësimore kanë  
**ndikim pozitiv në arritjet e nxënësve** dhe u  
mundësojnë atyre që të përdorin atë që kanë  
mësuar përtej fushës së një lënde të caktuar,  
të përdorin njohuritë e tyre në mënyrë  
krijuese dhe të zhvillojnë **të menduarit kritik  
dhe strategjitë efektive të të nxënësve.**



## SHQETËSIM

Koncepti **ndryshon përmbajtjen** që mësohet për historinë.



## SHPJEGIM

Koncepti për arsim fillor është një dokument udhëzues dhe **nuk specifikon ose fshinë përmbajtje nga lëndë të ndryshme**. Kjo rregullohet me programet mësimore që vijnë pas zhvillimit dhe miratimit të Konceptit. Programet mësimore do të hartohen nga mësimdhënës, profesorë universitarë dhe këshilltarë të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.



## SHQETËSIM

Integrimi i lëndëve mësimore është **një risi që nuk është verifikuar.**



## SHPJEGIM

Lëndët e integruara **nuk janë një risi në arsimin në botë, as në sistemin tonë arsimor** (një shembull i tillë është lënda e shkencave natyrore deri në klasën e gjashtë). Hulumtime të shumta tregojnë se programet e integruara mësimore **i ndihmojnë nxënësit** të dallojnë lidhjet midis dukurive të ndryshme natyrore dhe/ose shoqërore, të ndërlidhin atë që mësojnë me përditshmërinë dhe të zhvillojnë aftësi të të mësuarit gjatë gjithë jetës.



## SHQETËSIM

Numri i mësimdhënësve  
**do të zvogëlohet.**



## SHPJEGIM

Koncepti për arsim fillor nuk përcakton numrin e mësimdhënësve. Sidoqoftë, analizat e realizuara dëshmojnë se **TË GJITHË MËSIMDHËNËSIT MBETEN NË PUNË sepse numri i përgjithshëm i orëve në programin mësimor nuk është zvogëluar.** Me lëndët e parapara të lira zgjedhore, mësimdhënësit kanë lirinë dhe mundësinë për të përdorur kreativitetin e tyre në zhvillimin e programeve mësimore për lëndët zgjedhore, në përputhje me interesin dhe kërkesat e nxënësve.



## SHQETËSIM

**Zvogëlohet** numri i orëve për arsim muzikor dhe arsim figurativ.



## SHPJEGIM

Megjithëse numri i orëve për arsim artistik është zvogëluar në krahasim me fondin e orëve për arsim muzikor dhe figurativ, prapseprap **përmes lëndëve të lira zgjedhore nxënësit që tregojnë afinitet dhe talent për artet, kanë mundësinë të përcaktohen dhe zgjedhin një "modul" të arteve në të gjithë klasat e arsimit fillor.** Për më tepër, Koncepti parasheh realizimin e detyrueshëm të aktiviteteve jashtëshkollore që gjithashtu ofrojnë programe dhe aktivitete për zhvillimin e talentit artistik dhe edukimin e nxënësve.



## SHQETËSIM

Koncepti **nuk bazohet në nevojat dhe kërkesat** e mësimdhënësve.



## SHPJEGIM

Pikënisja e Konceptit është **një hulumtim i kryer në nëntor 2020 me 4168 mësimdhënës**, të cilët identifikuan nevojat për reformën arsimore dhe aspektet mbi të cilat ajo duhet të bazohet.



## SHQETËSIM

Nxënësit **nuk dëshirojnë të qëndrojnë më gjatë në shkollë.**



## SHPJEGIM

Koha e kaluar në mënyrë efektive në shkollë, në të cilën nxënësit në komunikim me mësime dhënësit janë **të angazhuar në mënyrë aktive** përmes aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore është e ndërlidhur me **arritje më të larta**, veçanërisht midis nxënësve që vijnë nga familje të cenuara sociale. Gjithashtu, nëse shkolla ofron aktivitete që lidhen me interesat e nxënësve, ata me **kënaqësi do të kalojnë më tepër kohë në shkollë.**



## SHQETËSIM

Mësimdhënësit **nuk janë aq kompetent/profesional** që të zbatojnë mësimdhënie të integruar.



## SHPJEGIM

Mësimdhënësit deri më tani kanë patur udhëzime që **të realizojnë një pjesë të përmbajtjeve mësimore në mënyrë të integruar** në bashkëpunim me kolegë të lëndëve të tjera. Ky komponent i mësimdhënies do të forcohet, ndërsa mësimdhënësit **do të marrin trajnime shtesë** për planifikimin dhe zbatimin e integruar të mësimdhënies.



## SHQETËSIM

Një mësimpldhënës **nuk mund të jetë kompetent për të ligjëruar të gjitha përmbajtjet** e shkencave natyrore ose shoqërore.



## SHPJEGIM

Mësimdhënien në shkollë e realizojnë **mësimdhënës kompetentë**. Kështu do të vazhdohet edhe me mësimdhënien e lëndëve të integruara. **Për secilën disiplinë mësimore të lëndës së integruar mësimore, mësimdhënien do të realizohet nga mësimpldhënësi përkatës**, që sipas planifikimit të parashikuar do të nënkuptojë se më tepër mësimpldhënës do të punojnë me nxënës në orët e shkencave natyrore dhe shkencave shoqërore.